


Zinxhiri i diturisë në sqarimin e çështjeve të metodologjisë (Menhexhit) – Pjesa 3

Tekfiri i Mushrikëve (1/2)

Me lejen e All-llahut në këtë pjesë do të fillojmë të flasim për tekfirin e mushrikëve.

Në këtë pjesë do të flasim për dy çështje:

Çështja e parë: Do t’i përgjigjemi pyetjes: “Cila është pozita e tekfirit në Fe?”

Çështja e dytë: Këtu do të përmendim objektin, motivin apo shkakun e kufrit të atij i cili ndalet në tekfirin e mushrikëve (pra dispozita e arsyetuesit).

Para se të fillojmë me çështjet e lartpërmendura, do t'i citojmë disa tekste të dijetarëve rreth kufrit të atij i cili nuk i bën tekfir jobesimtarët.

Thotë Ebu Hasan el-Meletij Esh-Shafi'ij, All-llahu e mëshiroftë: "Të gjithë Muslimanët janë të mendimit se kush dyshon në kufrin e ndonjë jobesimtari, ai është Kafir (jobesimtarë)." [1]

Thotë Kadi Ijadi, All-llahu e mëshiroftë: "E bëjmë Tekfir atë i cili nuk e bën tekfir njeriun i cili pason fe tjetër pos fes së Muslimanëve, ndalet apo dyshon në kufrin e tyre apo saktëson fen e tyre, edhe nëse nga jashtë beson dhe paraqet Fenë Islame dhe mohon saktësin e ndonjë feje tjetër, ai (arsyetuesi) është Kafir për shkak se ka paraqitur të kundërtën e asaj që proklamon (nga jashtë)." [2]

Thotë Imam Neveviu, All-llahu e mëshiroftë: "Kush nuk e bën Tekfir personin që pason fe tjetër pos Islamit si shembulli i Krishterëve, apo dyshon në kufrin e tyre, apo saktëson fen e tyre, ai është Kafir." [3]

Citon Haxh'xhavi, All-llahu e mëshiroftë, mbi tekfirin e "atij që nuk e bën tekfir personin i cili ndjek fe tjetër pos fesë Islame si shembulli i pasuesve të librit, dyshon në kufrin e tyre apo saktëson fen e tyre." [4]

Thotë Shejhu Muhamed ibn AbdulVehab, All-llahu e mëshiroftë: "Kush nuk i bën tekfir mushrikët, dyshon në kufrin e tyre apo saktëson fen e tyre, ai është kafir me ixhma (konsensus)." [5]

Mbaroi fjala e tyre, All-llahu i mëshiroftë.

1 Et-Tenbih ue-Rad ala ehlil-Ehvai uel Bidai, f.40
2 Esh-Shifa bi-Tarif Hukuk al-Mustafa, v. 2, f. 286.
3 Raudatu et-Talibin v. 10, f. 70.
4 El Ikana, v. 4, f. 298.
5 Ed-Duraru es-Sennije, v. 10, f. 91.

Tani fillojmë ta shtjellojmë çështjen e parë: Përgjigje ndaj pyetjes: Cila është pozita e Tekfirit në Fe?

Përgjjigje: Tekfiri është dispozitë e pastër sheriatike e nuk ka vend për logjikën këtu dhe nuk futet në çështjet dhe kuptimet e Aslu Dinit, çështje të cilën e kemi përmendur në pjesët e kaluara.
Pra tekfiri i mushrikëve është prej vaxhibateve (obligimeve) të Fesë dhe nuk është prej Aslu Dinit (bazës së fesë).

Mirë, atëherë cili është dallimi (mes Vaxhibit dhe Aslit)?

Dallimi qëndron në atë se, çështjet që i përfshin Aslu Dini nuk arsyetohet njeriu më injorancë në to dhe nuk kushtëzohet ngritja e argumentit për braktisësin e Aslu Dinit apo braktisësin e diçkaje nga Aslu Dini. Kurse tekfiri është dispozitë sheriatike që ekziston mundësia të arsyetohet me injorancë apo keqinterpretim (Te'vil).

Pastaj, çështja e Tekfirit nuk qëndron në një gradë, përkundrazi kemi gradë të ndryshe të tekfirit.

Shkalla më e lartë janë çështjet të cilat domosdoshmërisht dihen në Fe, si tekfiri i atyre që All-llahu në librin e Tij i ka bërë tekfir konkret si Iblisi, Firauni, dhe të gjithë ata që ndjekën Fe tjetër pos Islamit si Krishterët, Jehudët dhe adhuruesit e statujave, dhe deri te shkalla më e ulët që është tekfiri i atyre reth të cilëve ka polemikë, si lënësi i namazit dhe të tjerë. Mes shkallës më të lartë dhe asaj më të ulët kemi grada të ndryshme, e të cilat me lejen e All-llahut do t’i shtjellojmë në pjesët në vijim.
E përmendëm më lartë se tekfiri është prej vaxhibateve (obligimeve) të Fesë dhe se është dispozitë sheriatike, dhe nuk lejohet të argumentohemi për këtë me diç tjetër pos argumenteve sheriatike dhe nuk ka vend për logjikën këtu. Dijetarët janë ata që në vazhdimësi janë munduar ta pohojnë dhe vërtetojnë këtë që përmendëm, e ne do t’i paraqesim disa tekste te tyre:

Thotë Kadi Ijadi, All-llahu e mëshiroftë: "Kaptinë: cilat prej fjalëve janë kufër, cilat janë fjalë që ndalemi tek to apo ka polemik rreth tyre dhe cilat nuk janë kufër. Dije se për verifikimin e kësaj kaptine dhe zbulimin e paqartësisë në të, kthehemi tek Sheriati dhe për logjikën nuk ka hapsirë këtu." [6]

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: "Tekfiri është dispozitë Sheriatike, që ka të bëjë me lejimin e pasuris, derdhjen e gjakut dhe gjykimin me zjarr të përhershëm, burimi i kësaj dispozite është njëjtë si burimi i dispozitave të tjera të Sheriatit." [7]

Dhe thotë, All-llahu e mëshiroftë: "Kufri dhe Fisku janë dispozita sheriatike, e nuk janë prej dispozitave që logjika e ka pavarsinë e saj. Kafir është ai që All-llahu dhe i Dërguari i Tij e quajtën Kafir, Fasik është ai që All-llahu dhe i Dërguari i Tij e quajtën Fasik, njejtë sikur që Besimtar dhe Musliman është ai që All-llahu dhe i Dërguari i Tij e quajtën Besimtar dhe Musliman...” Deri kur thotë, “pra çështja, e gjitha, vendosen nga sheriati.” [8]

Dhe thotë, All-llahu e mëshiroftë: "Imani dhe Kufri janë dispozita të cilat janë të vërtetuara me risale (ardhjen e Pejgamberit ﷺ), dhe nëpërmjet argumenteve sheriatike bëjmë dallimin mes besimtarit dhe jobesimtarit, e jo duke u bazuar në argumentin e aklit (logjikës)." [9]

Thotë Ibn Kajimi, All-llahu e mëshiroftë:

“Kufri është dispozit e All-llahut dhe të Dërguarit... Me tekst të vërtetuar, e jo me fjalën e filanit...
Atë që Zoti dhe i Dërguari i tij e bënë Tekfir... Ai me të vërtetë është Jobesimtari.” [10]

6 Esh-Shifa bi-Tarif Hukuk al-Mustafa, v. 2, f. 282.
7 Bug’jetul Murtad, f.345.
8 Minhaxhu Sunneh en-Nebevije, v. 5, f. 92.
9 Mexhmua Fetawa, v. 3, f. 328.
10 Al-Kafijah esh-Shafijah, f. 858.

Thotë Ibn Vezir San'Ani, All-llahu e mëshiroftë: "Për dispozitat e Kufrit dhe Fiskut argument e kemi vetëm atë që është transmetuar në argumentet sheriatike të prera, e në këtë çështje nuk ka polemik." [11]

Për këtë themi: Kush nuk e di dispozitën sheriatike për njërin nga jobesimtarët, mushrikët apo njërin prej grupeve të tyre nuk e ka dispozitën si ai që i bën shirk All-llahut, për shkak se ai që bën shirk e ka prishur Aslu Dinin siç e përmendëm në pjesën e kaluar, përkundrazi personi i tillë e ka dispozitën e njejtë me atë i cili nuk ka dituri për ndonjë dispozitë apo obligim prej obligimeve të Islamit, e ai që kundërshton pasi që i është ngritur argumenti sheriatik bën kufër. kurse atij që nuk i ka arritur argumenti sheriatik për këtë çështje nuk është kafir (jobesimtarë), e që nuk nuk është njejtë me atë që nuk e di teuhidin i cili është Aslu Dini, i tilli është kafir për shkak të kufërit të injorancës.

Dijetarët vazhdimisht kanë pohuar dallimin mes injorancës në Aslu Din dhe Injorancës në vaxhibate (Obligime) Sheriatike.

Imam Muhamed Ibn Nasr el Mervezi, All-llahu e mëshiroftë, transmeton nga një grup i dijetarëve të hadithit se kanë thënë: "Pasi që njohja e All-llahut është iman dhe mosnjohja e All-llahut është kufër dhe veprimi me farzet (obligimet) është iman por mos njohja e tyre para se të shpallen (obligohemi me to) nuk është kufër... (deri kur thotë)... përkundrazi bën kufër ai që i mohon ato për shkak se me këtë ai e përgënjeshtron Shpalljen e All-llahut, e nuk konsiderohet kafir nëse nuk e di atë (farz, dispozitë) për shkak se nuk i ka arritur shpallja nga All-llahu, e nëse zbret shpallja dhe dikush prej Muslimanëve nuk ka dëgjuar për këtë dispozitë e cila është shpallur, Muslimani për këtë injorancë nuk konsiderohet kafir, kurse mos njohja e All-llahut në çfardo situate është kufër, para apo pas shpalljes." [12]

11 El-Mevasim vel-Kavasim, v. 4, f. 179.
12 Ta'Dhimu Kadri Salah, v. 2, f. 520.

Ngritja e argumentit dhe mënyra e realizimit të këtij kushti para tekfirit, varet nga qartësia dhe paqartësia e ndonjë çështje. Kemi situatë kur argumenti të ngrihet në prezencën e atij që ndalet në tekfir, e kemi për qëllim se kur ai ndalet (në tekfir) është kundërshtues e jo mosnjohës i dispozitës, e që në këtë situatë nuk arsyetohet pos i riu në Islam apo ai i cili jeton larg në shkretëtirë. Kemi situatë kur për ngritjen e argumentit është obligim shpjegimi i tekstit sheriatik i cili argumenton për kufrin e atij i cili flet apo vepron filan veprën dhe nuk mjafton vetëm arritja e përgjithshme e Kur'anit. Kemi situatë kur me ngritjen e argumentit dhe shpjegimin e tekstit është obligim largimi i dyshimit që është paraqitur nga argumenti i kundërt. Më vonë do të flasim më gjërësisht kur të flasim për llojet e atyre që ndalen në tekfir.

Argument në atë se ka dallim mes mos njohjes (injorancës) së disa dispozitave dhe mos njohjes së Aslu Dinit apo se tekfiri i mushrikëve është prej dispozitave që njihet me shpallje dhe nuk është nga Aslu Dini, kemi shumë dhe do t'i përmendim disa:

1. Të gjithë Pejgamberët popullin e tyre fillimisht e thirrën në adhurim e All-llahut të vetëm, sikur mosdija e dispozitave të tekfirit të ishte kufër, ata nuk do e linin këtë dispozit anash por do ta shpjegonin që në momentin e parë bashk me Aslu Dinin.

2. Prej argumenteve që aludojnë në dallimin se tekfiri është prej obligimeve të fesë e cila njihet me shpallje dhe se nuk është prej Aslu Dinit, është transmetimi ku thuhet se disa nga Sahabet, All-llahu qoftë i kënaqur me ta, u ndalën në tekfirin e disave të cilën ranë në ride (dalje nga feja) dhe i quajtën Muslimanë, e pasi që zbritën Ajete që e shpjeguan kufrin e atyre personave, nuk u kërkua nga këta Sahabë që u ndalën në tekfir, të pendohen, e transmetohet se njëri prej Sahabëve për shkak të mosdijes (injorancës) veproi shirk, Sahabët e bënë tekfir dhe Pejgamberi ﷺ e urdhëroi që të ripërtërin Islamin e tij, e kjo argumenton fuqishëm për dallimin mes atij i cili vepron shirk nga mosdija dhe atij që nuk e di ndonjë dispozitë sheriatike.

Nga Ibn Abasi, All-llahu qoftë i kënaqur me të, transmetohet të ketë thënë: "Disa nga banorët e Mekes e pranuan Islamin mirëpo e fshihnin atë, e mushrikët e Mekes i nxorën këta Muslimanë për në luftën e Bedrit, ku disa prej tyre u plagosën e disa u vranë. Dhe në këtë gjëndje thanë disa Muslimanë (që ishin me Pejgamberin ﷺ): Disa prej tyre ishin shokët tanë Muslimanë mirëpo ishin nxjerrë me dhunë për në Bedër, kërkoni nga All-llahu t'i falë ata. Dhe zbriti ajeti: **"Engjët që ua morën shpirtin atyre që ishin mizorë të vetvets ju thanë: Në çka ishit ju? Ata thanë: ne ishim të pa aftë në tokë (engjët than) A nuk ishte e gjërë toka e Allahut e të migronit në të, vend i tyre është Xhehenemi dhe sa vend i keq është ai"**,[13] Tha: Pra një mesazh u zbrit tek ata Muslimanët që ngelën (me mushrikët) që nuk ka justifikim për ta. Këta Muslimanë dolën (për të ikur) por papritmas mushrikët u vunë pas tyre dhe i tërhoqën ata në fitne (i sprovuan) ata dhe më pas zbriti ajeti: **"Ka disa njerëz që thonë: Besuam në Allahun, e kur t'i godet ndonjë e keqe (në rrugën e Allahut)..."** [14] [15]

Thotë Shejh Abdullah bin Muhamed bin AbdulVehab, All-llahu e mëshiroftë: "All-llahu e zbriti këtë ajet në të cilin qartësoi dispozitën e atyre mushrikëve dhe se ata janë banorë të zjarrit edhe pse kishin folur me Islam." [16]

Nga Sad ibn Ebi Vekas transmetohet të ketë thënë: "Ishim duke biseduar diçka e unë sapo e kisha lënë xhahiljetin (i ri në Islam) dhe u betova ne Latin dhe Uzanë, mjer pët ty çfarë the, shko dhe informoje të Dërguarin e All-llahut për atë që the, ne mendojmë se ti bëre kufër. E takova dhe e informova, e më tha: Thuaj *La ilahe il-lAll-llah Vehdehu* tri herë, Kërko mbrojtje (nga All-llahu) prej Shejtanit tri herë, pështy nga e majta tri herë, dhe mos e përsërit më." [17]

13 Surja En-Nisa, Ajeti 97.
14 Surja El-Ankebut, Ajeti 10.
15 Tefsiri Taberiut, v. 9, f. 102.
16 Ed-Duraru es-Sennije, v. 10, f. 241.
17 Nesaiu 7/3776.

Në spjegimine këtij hadithi Ibn Vezir San'ani, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Ka urdhëruar që ta ripërsërit Islamin (fenë)." [18]

Ibn Arabi el Maliki, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Në Islam kush betohet në Latin dhe Uzanë për ta vërtetuar betimin e tij në kuptimin e madhërimit, ky person është Kafir." [19]

Thotë Shejh Sulejman bin Abdilah, All-llahu e mëshiroftë: "Disa prej dijetarëve argumentohen me hadithin e Sadit, All-llahu qoftë i kënaqur me të, dhe thonë: Bën kufër kush betohet në dikë tjetër pos All-llahut, kufër të shirkut, dhe thanë: për këtë shkak Pejgamberi ﷺ e urdhëroi ta ripërtërinte Islamin (fenë) me shprehjen *La ilahe Il-lAll-llah*, e sikur mos të ishte kufër që të nxjerr nga feja nuk e urdhëronte me të. Shumica e dijetarëve thanë: (kush betohet në dikë tjetër pos All-llahut) nuk bën kufër që e nxjerr nga feja, mirëpo është prej shirkut të vogël." [20]
Shikoni ky Sahabi, All-llahu qoftë i kënaqur me të, nuk u arsyetua edhe pse ishte i ri në Islam.

Gjithashtu prej argumenteve që aludojnë në dallimin se tekfiri është prej vaxhibateve (obligimeve) të fesë e cila është dispozitë sheriatike (që mësohet nëpërmjet shpalljes) dhe se nuk është prej Aslu Dinit që nuk arsyetohet askush në të, është transmetimi ku disa Sahabë polemizuan reth tekfirit të disa murtedëve (felëshuesëve), e kur All-llahu e shpjegoi kufrin e atyre (murtedëve) nuk urdhëroi që ta ripërsërisin Islamin Sahabët që u ndaluan në tekfir.

Thotë All-llahu i Lartëmadhëruar (kuptimi): **"E çka është me ju që në çështjen e munafikëve jeni dy grupe; derisa për atë që bënë, All-llahu i përmbysi ata? a mos doni ta vini në rrugë të drejtë atë që All-llahu e ka humbur? Për atë që All-llahu e ka humbur, nuk do të gjeni rrugë"** [21]

18 Ithar el-Haki ale el-khalki f. 380.
19 Aaridatu el-Hvedhi v. 1, f. 28.
20 Tejsirul Azizil Hamid, f. 529.
21 Surja En-Nisa, Ajeti 88.

Në transmetim të saktë thuhet se shkak i zbritjes ishte ngjarja kur Pejgamberi ﷺ doli për në Uhud e disa njerëz që ishin me të u kthyen mbrapa, e Shokët e Pejgamberit ﷺ që mbetën me të u ndanë në dy grupe, disa than "Ti vrasim" e disa të tjerë thanë "Jo".[22]

Në transmetim të saktë nga Muxhahidi, All-llahu e mëshiroftë, se ka thënë: "Një grup njerëzish dolën nga Meka dhe erdhën në Medine me pretendimin se janë Muhaxhirë e që ma pas të njëjtët bënë ride (dolën nga feja). Kërkuan leje nga Pejgamberi ﷺ për të shkuar në Meke që të bënin tregëti me mallin e tyre. Për këtë grup besimtarët polemizuan, disa thanë: "Ata janë munafikë", e disa thanë: "Ata janë besimtarë". All-llahu e shpjegoi Nifakun e këtij grupi dhe urdhëroi që të luftohen." [23]

Në këtë kuptim transmetohet edhe nga Abdurahman ibn Aufi dhe Ibn Abasi, All-llahu qoftë i kënaqur me ta, dhe në transmetim "mursel" transmetohet nga një grup i Tabi'inëve, Ikrime, Sudiju, Katade, Muhamed ibn Ka'b el Kuradhij, All-llahu i mëshiroftë.

Imam Tabariu në shpjegimin e këtij Ajeti, **"E çka është me ju që në çështjen e munafikëve jeni dy grupe; derisa për atë që bën, All-llahu i përmbysi (ktheu) ata?..."**, thotë: Pra All-llahu i ktheu ata në dispozitat e jobesimtarëve, në derdhjen e gjakut dhe robërimin e farefisit." [24]

Imam Tabariu anon në mendimin se ky ajet ka zbritur për një grup i cili bënë ride (dolën nga feja). Ai pasi që i citoi fjalët e Selefit për shkakun e zbritjes së këtij ajeti tha: "Mendimi më parësorë që të jetë i saktë, është mendimi i atyre që thonë, se ky ajet zbriti për polemikën që patën shokët e të Dërguarit të All-llahut ﷺ reth një grupi nga Meka të cilët bënë ride pasi që kishin pranuar Islamin." [25]

---

22 Buhariu dhe Muslimi.
23 Tefsiri i Taberiut 8-9/10052.
24 Tefsiri Tabariut, v. 8, f. 7.
25 Tefsiri i Taberiut, v. 8, f 13.

Ibn ebi Zemenin, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Ata ishin një grup i munafikave që banonin në Medine të cilët dolën nga aty për në Meke e prej Mekes për në Jemame për të bërë tregti. Bënë ride nga Islami (dolën nga feja) dhe e shfaqën atë që fshihnin në zemrat e tyre prej shirkut. Kur Muslimanët u takuan me këtë grup u ndanë në dy mendime, një grup tha: “Gjaku i tyre është hallall, ata janë mushrikë, murtedë”, e grupi tjetër tha: “Jo gjaku i tyre nuk është i lejuar, ata janë një popull të cilët kanë rënë në fitne”, e All-llahu tha (kuptimi): **"E çka është me ju që në çështjen e munafikëve..."** [26] [27]

Gjithashtu prej argumenteve në këtë çështje është animi i disa dijetarëve në mendimin se Umer ibn Hatabi, All-llahu qoftë i kënaqur me të, u ndal në tekfirin e mosdhënësve të Zekatit në fillim, e pasiqë Ebu Bekri, All-llahu qoftë i kënaqur me të, i’a shpjegoi kufrin e tyre ai e përkrahu Ebu Bekrin, megjithatë nuk u kërkua nga ai që të pendohet.

Në një transmetim të saktë citohet se Umeri, All-llahu qoftë i kënaqur me të, për çështjen e murtedëve i tha Ebu Bekrit, All-llahu qoftë i kënaqur me të: "Si po i lufton njerëzit? kurse i Dërguari i All-llahut ka thënë: *“Jam urdhëruar që ti juftoj njerëzit derisa ata të thonë La ilahe Il-lAll-llah, e kush e thotë këtë ai e ka ruajtur pasurinë dhe veten e tij nga unë pos me hakun e tyre, kurse llogaria e tij është në dorën e All-llahut."* [28]
Disa nga dijetarët e Selefit (në fillim të çështjes) u ndalën në kufrin e atyre që thonin se Kur’ani është i krijuar, e kishte prej tyre që nuk e dinin kufrin e Xhehmive pavarësisht vështirësis së tij, mirëpo me këtë ata (që u ndalën në tekfir) nuk u konsideruan jobesimtarë, për shkak se kur atyre i'u shpjegua argumenti mbi kufrin e tyre ata nuk u ndalën, mirëpo edhe nuk i'u kërkua njërit prej tyre që ta ripërtërin Islamin e tij për shkak të mos’tekfirit të mëhershëm.

26 Surja En-Nisa, Ajeti 88.
27 Tefsirul Kur'anil Aziz (Ibn Ebi Zemnin), v. 1, f. 393.
28 Buhariu dhe Muslimi.

Nga Jakub ibn Ibrahim Ed-Deurakiji, All-llahu e mëshiroftë, se ka thënë: E pyeta Imam Ahmedin për atë që thotë: “Kur'ani është i krijuar?” Më tha: Më herët nuk i kam bërë tekfir, derisa i lexova disa ajete nga Kur’ani (kuptimi): **"...E nëse i pason epshet e tyre pas asaj që të erdhi nga dituria...",** [29] dhe fjala e Tij (kuptimi): **"...pas asaj që të erdhi nga dituria...",**[30] dhe fjala e Tij (kuptimi): **"...e zbriti atë me diturin e tij..."**.[31] [32]

Ibn Amar el-Mosuliji, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Më tha Ibn Medini: Cila është pengesa për mos’tekfirin e tyre? Pra Xhehmive. Tha: E unë në fillim të çështjes nuk i bëja tekfir, derisa tha Ibn Medini atë që tha. Më vonë kur ai (Ibn Medini) ra në fitne, i shkruajta atij në letër, i'a përkujtova All-llahun dhe i'a përkujtova fjalët që mi thoshte për tekfirin e tyre." [33]

E me këtë e kemi mbaruar çështjen e parë.

Tani do fillojmë të flasim për çështjen e dyte e ajo është: Cili është objekti, motivi apo shkaku i kufrit të atij i cili ndalet në tekfirin e mushrikëve (pra dispozita e arsyetuesit)?

Përgjigjeja: Shkaku i kufrit të tij (arsyetuesit) është përgënjeshtrimi dhe refuzimi i teksteve sheriatike.

Duke i shikuar citatet e dijetarëve për këtë anullues, qartas shohim atë që ata e vërtetuan se shkaku i kufrit të atij që ndalet në tekfirin e jobesimtarit është përgënjeshtrimi dhe refuzimi i teskteve sheriatike, e jo nga këndi i anullimit në Aslu Din.

29 Surja Bekare, Ajeti 145.
30 Surja Bekare, Ajeti 120.
31 Surja En-Nisa, Ajeti 166.
32 Ibn Ebi Ja'la në Tabakatul Hanabileti, v. 1, f. 414.
33 Tarikhu Bagdad, v. 13, f. 421.

Vazhdimisht shumica e dijetarëve e kanë përmendur këtë shkak duke u bazuar në atë se kufri realizohet duke i mohuar dispozitat mutevatir (me pajtimin e të cilave janë të gjithë), apo mohon diçka që domosdoshmërisht është e njohur në fenë tonë.

Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Kufri ndodh nëse mohohen gjërat që domosdoshmërisht janë të njohura në fe, apo me mohimin e asaj që është transmetuar në rrugë mutevatir (të padyshimta) dhe janë të pajtimit të gjithë." [34]

Do ti paraqesim disa nga citatet e dijetarëve të cilët flasin për shkakun e kufrit të atij që ndalet në tekfirin e jobesimtarëve:

Kadi Ijadi kur flet për tekfirin e atij që nuk i bën tekfir Krishterët, Jehudët dhe atë që e lënë fenë Islame, këtë çështje e shpjegon me një transmetim të Bakil-lanit ku thotë: "Për shkak se ixhmaja (konsensusi) është arritur për kufrin e tyre, për shkak se kush ndalet (në tekfirin e tyre) apo dyshon në të, ky person e ka përgënjeshtruar citatin sheriatik, e përgënjeshtrimi apo dyshimi nuk shfaqet pos nga një Kafir." [35]

Ibn Uezir San'Ani, All-llahu e mëshiroftë, kur flet për tekfirin e atij që dyshon në adhuruesit e putave dhe ndalet (në tekfirin) e tyre, thotë: "Nuk kemi ndonjë shkak tjetër pos që kufri i tij është domosdoshmërisht i njohur në fe." [36]

Shejhu Abdullah bin Muhamed ibn AbdulVehab, All-llahu e mëshiroftë, kur e qartëson tekfirin mbi ata që thonë se "kush i dëshmon dy dëshmitë (shehadetin), nuk lejohet tekfiri i tyre edhe nëse adhuron dikë me All-llahun", thotë: "Thënësi i kësaj fjale është përgënjeshtrues i All-llahut, të Dërguarit të Tij dhe konsensusit të Muslimanëve." [37]

---

34 Mexhmu el-Fetava, v. 1, f. 106.
35 Esh-Shifa, v. 2, f. 280.
36 Er-Raud el-Basim, v. 2, f. 509.
37 Ed-Durar es-Sennije, v. 10, f. 250.

Disa nga dijetarët e Nexhdit thanë: "Ai që nuk i bën tekfir mushrikët, ka përgënjeshtruar Kur’anin, për shkak se Kur’ani i ka bërë tekfir mushrikët dhe ka urdhëruar tekfirin, armiqësimin dhe luftimin e tyre." [38]

Me kaq e përfundojmë për deri në pjesën e ardhshme me lejen e All-llahut.

Nga All-llahu kërkojmë ndihmë, sukses dhe saktësi, lutjet, selamet dhe begatit e All-llahut qofshin mbi Robin dhe të Dërguarin e tij Muhamedin, mbi familejn dhe shokët e tij.

Fundi i pjesës së tretë (3/6)
Përktheu: Ebu Lejth Albani

38 Ed-Durar es-Sennije, v. 9, f. 291.

